



Kuvendi i Komunës Klinë
Komiteti për Politikë dhe Financa
01Nr 06-35731 /23
Klinë,dt: 13, 10 /23

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e IX e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur, më 21.09.2023, me fillim nga ora 09:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi, z. Fadil Gashi, i cili përshëndeti të gjithë anëtarët e Komitetit, OSBE-në, drejtorë të drejtorive dhe gjithë të pranishmit.

Kryesuesi, prezantoi rendin e ditës:

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi i raportit të procesit të konsultimeve publike për draft-buxhetin e komunës së Klinës për vitin 2024 (ref. Drejt. Fin.),
3. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim për rialokim të mjeteve financiare (ref.Drejt.Fin.),
4. Të ndryshme.

Fadil Gashi, kryesues: Përshëndetje për të gjithë, mirë se keni ardhur në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa! Jemi katër anëtarë, ne mund të procedojmë, po besoj që rendin e ditës e keni marr në procedura pak më të shkurtra duke u munduar që ta zëmë hapin para seancës që e

kemi nesër. Nëse ka dikush për rend të ditës, urdhëroni? A jeni për këtë rend të ditës, kush është për?

Me 4 vota PËR, u miratua rendi i ditës.

1. Arsyetimi i mungesave.

Fadil Gashi, kryesues: Në pikën e parë të arsytimit të mungesave unë edhe njëherë po konfirmoj që nuk kemi të lajmëruar për mungesë, ndoshta na bashkohen, nuk e di!

2. Shqyrtimi i raportit të procesit të konsultimeve publike për draft-buxhetin e komunës së Klinës për vitin 2024 (ref. Drejt. Fin.).

Fadil Gashi, kryesues: Unë ja kisha kaluar menjëherë fjalën drejtorit, urdhëro, drejtor?

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Faleminderit, kryesues, përshëndetje për të gjithë! Realisht, duke u bazuar në Ligjin për Buxhet dhe Financa dhe Ligjin për Financa Publike, ne kemi bërë përpjekje që me kohë ta fillojmë procedurën për KAB-in për dëgjimet buxhetore për vitin 2024-2025 dhe 2026 dhe gjatë kësaj periudhe ne kemi zhvilluar shumë takime nëpër nivele të lokaliteteve të ndryshme të komunës sonë, pothuajse nëpër të gjitha.

Mandej kemi bashkëbiseduar edhe me të gjitha strukturat tjera, siç janë: bizneset, rina, gratë, bujqit, sportistët etj., dhe në kuadër të gjitha këtyre takimeve që ne i kemi realizuar në terren dhe bashkë me ekzekutivin, ne kemi ardhur në përfundim në këtë draft-buxhet që ju besoj e keni marr dhe e keni parë edhe agjendën e gjithë këtyre takimeve që i kemi zhvilluar.

E kemi edhe përfaqësuesin e DEMOS-it, që faktikisht ka qenë aktiv dhe ka qenë mbështetës në njëfarë forme edhe në terren, me prezantimin e KAB-it, kështu që, jemi munduar duke i përfshirë edhe organizatat joqeveritare, shoqëritë civile, dmth krejt këto takime dhe agjenda që ne i kemi zhvilluar e kanë mundësuar që ta kemi para vetes këtë draft-buxhet për vitin 2024-2025 dhe 2026 i cili nesër do të prezantohet para asamblistëve të asamblesë komunale Klinë, që në njëfarë forme ta merr vizën përfundimtare dhe që ndoshta kisha me thënë një prej vendimeve më të rëndësishme që brenda vitit të kaluar, që kuvendi e nxjerr është hartimi ose votimi i projektbuxhetit për vitin vijues.

Kështu që, unë nuk e kisha zgjatur më shumë, ju me siguri i keni parë këto shifra, e keni parë agjendën që e kemi zhvilluar në terren. Kush ka pasur mundësi edhe prej asamblistëve edhe prej këtyre aktivistëve kudo e ka parë të drejtën edhe mundësitë me u kyç në kërkesa dhe në prezantime edhe në propozime të ndryshme rreth këtyre projekteve, dhe unë mendoj që jo me mundësinë 100 % për kërkesat e të gjithë qytetarëve tonë, sepse ky buxhet është i limituar dhe është buxhet që aprovohet edhe nga niveli qendror, që në njëfarë forme ai na i paracakton kornizat me të cilat ne kemi me vepruar, kështu që, edhe përkundër kësaj, unë mendoj që është

bërë një zgjidhje më e mira e mundshme për vitin 2024.

Ndërsa mundësia për ta ndryshuar projektbuxhetin për vitin 2025-2026 është prapë gjatë debateve që do të mbahen në vitet vijuese, por, unë kisha kërkuar nga ju, që t'ia japim vizën këtij draft-buxheti dhe atij procesverbali të agjendës së takimeve në nivel të KAB-it që të shkojë për kuvend, faleminderit, kryesues!

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit edhe nga ju, drejtor! Unë po hap debat për anëtarët e KPF-së, nëse ka dikush, urdhëroni? Ne veç raportin e kemi të shkoqitur në organizimet që i kemi bërë, ekzekutivi, duke i përfshirë edhe dëgjimin që e kemi organizuar edhe ne si kuvend, është diçka që procedura duhet formalizuar edhe me votë, më në fund, për ta përcjellë për kuvend. A ka dikush? Po, Tunë Deda?

Tunë Deda: Përshëndetje, kryesues, përshëndetje për ju të gjithë! Unë e kam parë me vëmendje projektbuxhetin për vitin 2024-2026 edhe në komitetin e mëhershëm kur kam marr pjesë kam thënë që nuk është buxhet i përfshirë në gjitha regjionet, për mua personalisht, është lënë shumë anash, p.sh., kam kërkuar ndërrim trotuari prej Klinës deri në Zllakuqan, trotuar dy metra me ndriçim, kam kërkuar të bëhet trotuari për Jagodë, kam kërkuar të bëhet më shumë për bujqësi edhe këtu po shoh prapë nuk është bërë ndonjë ndryshim, nuk janë të paraparë për investime, edhe e konsideroj se në disa vende është bërë shumë më shumë...

Fadil Gashi, kryesues: A bën veç një ndërhyrje të shkurtër? Ti mirë e ke, por sot e kemi veç raportin e dëgjimeve publike e atë nuk mund ta sanojmë deri nesër bashkarisht, ato kërkesa tjera. A ka dikush prej anëtarëve të kuvendit të dëgjimet, të organizimi i debateve, të kërkesat, se unë po e shoh që janë të shkoqitura edhe këto. Besoj që edhe anëtarët e kuvendit e marrin këtë raport, duke e pasur për bazë që është kah kërkohet aprovimi i tyre, pastaj çka hynë në buxhet dhe çka ne kemi debatuar nesër, mund të debatojmë sot, pas këtyre takimeve, a ka dikush, nëse s'ka, kush është për?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të raportit të procesit të konsultimeve publike për draft-buxhetin e Komunës së Klinës për vitin 2024, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, me 4 vota PËR, rekomandoi që raporti të kalojë për shqyrtim në kuvend.

Fadil Gashi, kryesues: Unë besoj se tash është pjesë përbërëse e komplet dokumentacionit që nesër e shqyrtojmë në seancë të kuvendit.

Pika 3. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim për ri-alokim të mjeteve financiare (ref.Drejt.Fin.).

Fadil Gashi, kryesues: Meqë e kemi mbajtur këtë komitet e shfrytëzuam rastin që të mos

humbim kohë deri në komitetin e radhës, që ta shqyrtojmë edhe këtë kërkesë, nëse ka edhe Drejtorja diçka? Urdhëro, drejtor?

Enver Berisha, drejtor i FEZH: Nuk e di a e keni kërkesën ju për ri-alokim të mjeteve! Nga dy kode që janë për bashkëfinancim, një është në vlerë prej 40 240,00 euro, ndërsa vlera tjetër që është 11 753,00 euro, këto janë mjete që kalohen nga kodi i bashkëpronësimit në një projekt kapital që është fjala për asfaltimin e rrugëve Volljakë- Sferkë, që në fakt projekti ka përfunduar dhe është mungesë e pak mjeteve për ta kompensuar udhëkryqin, kështu që, dmth edhe me kryetarin..që këto mjete merren nga kodi i bashkëfinancimit.

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, drejtor, a ka dikush prej anëtarëve të komitetit? Urdhëro, Tunë Deda?

Tunë Deda: Është me rëndësi që është punuar rruga atje dhe njerëzve duhet me jua paguar lekët edhe pajtohem me këtë projekt, që është dashur m'i ri-alokuar mjetet..

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, Tunë, dikush tjetër? Po e shoh që nuk ka, a jeni që kjo kërkesë të rekomandohet për seancë?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës për ri-alokimin e mjeteve financiare për projekte kapitale, me 4 vota PËR, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoi që propozim-vendimi të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 4. Të ndryshme.

Fadil Gashi, kryesues: Të ndryshme, a ka dikush?
Atëherë ju falënderoj për pjesëmarrje dhe angazhim, shihemi në takimin e radhës!

Procesmbajtësja,
Monika Palushi



KRYESUESI,
Fadil Gashi

